

Programi i Unionit Evropian "IPA II" për "Kosovën"

Produkti D1.4.1

Manuali

"Lëvizja Përpara:

Promovimi i efikasiteit dhe efektivitetit
më të madh në luftë kundër Trafikimit të
Qenieve Njerëzore në Kosovë"



Projekt i Financuar nga BE dhe i menaxhuar nga
zyra e BE në Kosovë



Projekt i implemetuar nga
Family and Childcare Centre
(KMOP)



Kontrata Nr:
2016/382-826

Manuali



INSTRUMENTI PËR ASISTENCË PARA PRANIMIT (IPA II)
Vija Buxhetore: BGUE-B2014-22.020101-C1-ELARG DELKOS
Referenca: EuropeAid/150787/DD/ACT/XK

**“LËVIZJA PËRPARA: PROMOVIMI I EFIKASITETIT DHE
EFEKTIVITETIT MË TË MADH NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT
ME QENIE NJERËZORE NË KOSOVË”**

NUMRI I KONTRATËS: 2016/382-826

Produkti D1.4.1

Manuali

Informata të dokumentit

Data e caktuar e dorëzimit	31/07/2017
Data e dorëzimit aktual	31/07/2017
Emri i organizatës dhe kontraktorit Lider për këtë produkt	EPLO
Revizioni	2.0

Dissemination Level

PU	Publik	X
PP	I Kufizuar për pjesëmarrësit e programit (përfshirë shërbimet e komisionit)	
RE	I Kufizuar për grupin e specifikuar nga Konzorciumi (përfshirë shërbimet e komisionit)	
CO	Konfidencial, vetëm për anëtarët e konzorciumit (përfshirë shërbimet e komisionit)	

Lista e autorëve	
Autori	Partneri
Vasiliki Artinopoulou	EPLO
Alexandra Koufouli	EPLO
Iro Michael	EPLO
Rishikuesit	
Rishikuesi	Partneri
Antonia Torrens	KMOP
Vassia Karkantzou	KMOP
Hamijet Dedolli	PVPT
Floriana Ferri	PVPT
Versioni	
Versioni	Përmbledhja
1.0	Zhvillimi i Draft versionit v01
2.0	Versioni Final

Projekti është i financuar me përkrahjen me e Komisionit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si refleksion i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	4
LISTA E SHKURTESAVE	6
LISTA E PËRKUFIZIMEVE	Error! Bookmark not defined.
Hyrje	9
Informata përcjellëse	Error! Bookmark not defined.
Qëllimi dhe përmbajtja e Manualit.....	10
1. Komisioni për kompensimin e viktimave të krimit	12
1.1 Përbërja e Komisionit dhe Sekretariatit	12
1.2 Kohëzgjatja e emërimit	12
1.3 Proceset vendim-marrëse	13
2. Principet udhëzuese	13
3. Të drejtat e Viktimës	14
4. Forma e aplikacionit dhe dokumenteve përkrahëse	14
5. Kërkesa për informata shtesë	17
6. Afatet kohore për dorëzimin e aplikacioneve	18
7. Hapat procedural për vlerësimin e kërkesave	20
Hapi 1. Pranimi i aplikacionit	20
Hapi 2. Regjistrimi i aplikacionit.....	20
Hapi 3. Njoftimi i aplikuesve	20
Hapi 4. Shqyrtimi fillestarë.....	20
Hapi 5. Vlerësimi kryesor.....	21
Hapi 6. Vlerësimet për llojin e dëmtimeve	24
(A) Kompensimi për plagë serioze fizike apo dëmtim të shëndetit	24
(B) Kompensimi për shqetësim serioz të shëndetit mendor	25
(C) Kompensimi për humbjen e të afërmit.....	27
(D) Kompensim për humbjen e aftësisë për punë dhe vetë-mbajtje.....	27
(E) Kompensimi për shpenzime mjekësore dhe hospitalizim.....	28
(F) Kompensimi për dëmtimet nga shkatërrimi i pajisjeve mjekësore	29

(G) Kompensimi për shpenzimet e funeralit	30
(H) Shpenzimet procedurale për plotësimin e aplikacionit për kompensim	31
(I) Transferi kërkesës për kompensim	31
Hapi 7. Kalkulimi Final	32
(A) Kompensimi nga burimet e tjera	32
(B) Rrethanat ndikuese në kompensim.....	32
Hapi 8. Vendimi.....	33
Hapi 9. Njoftimi mbi vendimin	33
Grafiku	34
8. Fondet e fituara padrejtësisht.....	36
9. Situatat ndërkufitare	36
9.1 Situatat ndërkufitare nacionale.....	36
9.2 Situatat e huaja ndërkufitare	38
10. Të dhënat personale – Mbrojtja e të dhënave	39
10.1 Kërkesa e të dhënave	39
10.2 Qasja në të dhëna.....	39
11. Mbajtja e shënimeve.....	40
11.1 Regjistrimi	40
11.2 Dokumtni i komisionit.....	40
11.3 Rilëshimi i dokumenteve	41
11.4 Qasja në shënime	41
11.5 Kohëzgjatja e ruajtjes (magaznimit)	41
12. Aspektet financiare	41

LISTA E SHKURTESAVE

Lista e Shkurtesave	
UA (QRK) Nr 01/2017	Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 01/2017 për Mënyrën e Kompensimit duke përfshirë Llogaritjen e Kompensimit për Dëmtimet e Shumëfishta. Miratuar në mbledhjen e 127 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin Nr. 01/127, të datës 13.01.2017.
UA (QRK) Nr 02/2017	Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 02/2017 Mbi Regjistrat për Aplikuesit dhe Vendimet e Lëshuara mbi Kompensimet. Miratuar në mbledhjen e 127 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin Nr. 02/127, të datës 13.01.2017.
Kodi Penal	Kodi Nr. 04 / L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës Miratuar nga Kuvendi, me datën 20.04.2012 dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-399, të datës 22.06.2012
Kodi i Procedurës Penale	Kodi Nr. 04 / L-123 Kodi i Procedurës Penale Miratuar nga Kuvendi, me datën 13.12.2012, dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr. DL-57-2012, të datës 21.12.2012
Ligji Nr. 03/L-006	Ligji Nr. 03 / L-006 për procedurën kontestimore Aprovuar nga Kuvendi, me datën 30.06.2008 dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL-045-2008, të datës 29.07.2008.
Ligji Nr. 04/L-118	Ligji Nr. 04 / L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03-L-006 për procedurën kontestimore Miratohet nga Kuvendi, me datën 13.09.2012 dhe shpallet me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr. DL-045-2012, të datës 28.09.2012
Ligji Nr. 04/L-218	Ligji Nr. 04 / L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit Aprovuar nga Kuvendi, me datën 31.07.2013, dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr. DL-43-2013, të datës 19.08.2013
Ligji Nr. 05/L-036	Ligji Nr. 05 / L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit Miratuar nga Kuvendi, me datën 28.05.2015, dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL-009-2015, të datës 15.06.2015

LISTA E PËRKUFIZIMEVE

Përkufizimet e termeve të përdorura në Manualin aktual janë paraqitur në tabelën e mëposhtme sipas Nenit. 3, pika 1 e Ligjit Nr. 05 / L-036:

Përkufizimet	
Viktimë e Krimit	personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale. (Neni 19, §1.7, Kodi i Procedurës Penale). Për qëllim të kompensimit ky term përfshin gjithashtu, në raste të caktuara, anëtarin e familjes apo vartësit e viktimës;
Vartësit	nënkupton personat e mbajtur nga i vdekuri dhe personat të cilët kanë pasur të drejtë me ligj që të kërkojnë të mbahen nga i vdekuri;
Anëtari i Familjes	prindi, prindi i adoptuar, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore (Neni 120, § 33, Kodi Penal i Republikës së Kosovës);
Vepër e dhunshme e kompensueshme	një vepër kriminale e dhunshme, e përcaktuar me këtë ligj si e kompensueshme, dhe e cila rezulton në vdekjen e viktimës, lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit fizik apo mendor;
Fëmijë	person i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet. (Neni 120, pika 20, Kodi Penal i Republikës së Kosovës);
Dëmi	dëmi që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë rezulton nga një veprim kriminal, duke përfshirë humbjen e pronës, humbjen e fitimit, heqjen e lirisë, dëmtimin fizik, dëmtimin psikik apo humbjen e jetës së bashkëshortit ose anëtarit të familjes së afërme.
Shpërftyrim	kur viktima si pasojë e veprës kriminale është deformuar apo shëmtuar;
Parashtruesi i kërkesës	një individ që paraqet një kërkesë për kompensim me pretendimin se ai është viktimë e krimit. Ky term përfshin edhe persona të tjerë që mund të paraqesin një kërkesë në emër të viktimës;
Përfituesi	nënkupton personin i cili me vendim të komisionit përfiton nga e drejta për kompensim sipas këtij ligji;
Komisioni	nënkupton komisionin për kompensimin e viktimave të krimit
Viktima e trafikimit	ka të njëjtin kuptim si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës Neni 171 §6.1 -6.4: Viktima e trafikimit është viktimë e veprimeve të mëposhtme: rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit,

	<p>keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.</p> <p>Megjithatë, një fëmijë do të konsiderohet "viktimë e trafikimit" kur është rekrutuar, transportuar, transferuar, strehuar ose marrë për qëllime shfrytëzimi, pavarësisht nga mjetet e vendosura ose të përdorura për këtë qëllim.</p> <p>Për qëllime të kësaj dispozite termi "shfrytëzim" përfshin, por nuk kufizohet në shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.</p> <p>Pëlqimi i viktimës për shfrytëzimin siç përshkruhet më sipër është e parëndësishme.</p>
Viktimë e ndjeshme	fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë ose partner familjar (Neni 120, pika 37, Kodi Penal i Republikës së Kosovës);
Reciprocitet	reciprocitet me një shtet tjetër nënkupton që qytetarët e Republikës së Kosovës kanë qasje të barabartë në kompensim nën sistemin e kompensimit të viktimës në atë shtet;
Territor i Republikës së Kosovës	sipërfaqet tokësore dhe sipërfaqet ujore brenda kufijve dhe vijës kufitare si dhe hapësirës ajrore mbi Kosovë (Neni 120, §25, Kodi Penal i Republikës së Kosovës).

Hyrje

Qëllimi i këtij Manuali është të ofrojë një analizë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse mbi aspektet operacionale dhe procedurale të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, më poshtë i referuar si 'Komisioni'¹, i cili është krijuar kohët e fundit për shqyrtimin e kërkesave për kompensim në kontekstin e Programit për Kompensimin e Viktimës së Krimit në Kosovë.

Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Lëvizja përpara - Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit më të madh në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore në Kosovë" i zbatuar nga Qendra për Kujdes të Familjes dhe Fëmijës (KMOP) në bashkëpunim me Organizatën Evropiane të Ligjit Publik EPLO (GR) dhe Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qënieve Njerëzore (PVPT) në Kosovë (financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë). Projekti filloi në Janar 2017 dhe do të zgjasë deri në Janar 2020 me objektivin e përgjithshëm për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore (TQNj) në Kosovë duke rritur aftësinë e institucioneve të Kosovës për të koordinuar dhe zbatuar në mënyrë efektive të gjitha masat kundër -TQNj, në përputhje me praktikat më të mira të legjislacionit të BE-së dhe prioritetet e përgjithshme të zhvillimit të Kosovës.

Ky raport përbën një pjesë të aktiviteteve që mbështesin ngritjen e një sistemi të integruar të kompensimit të viktimave në Kosovë, i zhvilluar në kontekstin e veprimeve të ndihmës teknike të projektit. Megjithëse Programi i Kompensimit të Viktimave parasheh kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në viktimat e trafikimit, këto të fundit pritet të jenë një nga përfituesit kryesorë të Programit. Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04 / L-218 "Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit", viktimat e trafikimit kanë të drejtën e kompensimit të shtetit në rastet kur kompensimi nga kryerësit është i mundshëm ose nëse autorët e krimit nuk janë identifikuar, ndjekur penalisht ose nuk janë dënuar. Prandaj bëhet sigurimi i një të drejte tjetër të arritshme për viktimat e tilla.

Informata përcjellëse

Korniza për Kompensimin e Viktimave në Kosovë është zhvilluar gradualisht gjatë disa viteve të fundit. Fillimisht, e drejta e viktimave për kompensim është themeluar në Kodin e Procedurës Penale të vitit 2013. Ligji Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, themelimi dhe detajimi i funksionimit të Programit të Kompensimit të Viktimave të Krimit, u miratua në Maj të vitit 2015 dhe Nenet që rregullojnë kompensimin e viktimave hynë në fuqi një vit më vonë, në Maj 2016.

Ligji rregullon të drejtën e viktimave të krimeve të dhunshme, duke përfshirë viktimat e trafikimit dhe vartësit e tyre, për të marrë kompensim financiar nga shteti në rastet kur dëmshpërblimi direkt nga kryerësi nuk është i mundur. Gjithashtu, krijon autoritetin kompetent vendimmarrës, përkatësisht Komisionin, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për kompensime, si dhe procedurat sipas të cilave zbatohet e drejta për kompensim në situatat nacionale dhe jashtë kufinjëve (ndërkufitare).

Pas miratimit të Ligjit Nr. 05/L-036, anëtarët e Komisionit që shqyrtojnë kërkesat për kompensim, janë emëruar më 10 Gusht 2016 dhe dy Udhëzime Administrative (UA) që më tej detajojnë veprimet e tyre, janë lëshuar në Janar të vitit 2017. UA (QRK) Nr. 01/2017 përcakton mënyrën e dhënies së kompensimit, përfshirë zbatimin, llogaritjen dhe proceset e vendimmarrjes, dhe UA (QRK) Nr. 02/2017 rregullon formën dhe mënyrën e mbajtjes së të dhënave për të gjitha kërkesat dhe vendimet për kompensim.

Formularët përkatës të aplikimit dhe udhëzimet për aplikantët për kompensim u lëshuan nga Ministria e Drejtësisë më 11 Maj 2017, pasuar nga një ceremoni zyrtare e lansimit e organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe e mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë më 22 Maj. Më pas, më 24 Maj 2017, është themeluar Sekretariati që siguron mbështetjen e nevojshme administrative dhe teknike për veprimet e Komisionit.

Duke marrë parasysh periudhën e shkurtër kohore që nga fillimi i Programit dhe kohën e shkrimit të këtij raporti në Korrik 2017, asnjë kërkesë për kompensim ende nuk është dorëzuar ose shqyrtuar nga Komisioni.

Për qëllime të raportit aktual, hulumtimi në vend pune dhe analiza ligjore e dokumenteve relevante legislative u zhvillua gjatë muajve Maj dhe Qershor 2017. Përveç kësaj, përmbajtja e raportit është zhvilluar në bazë dhe në përputhje me kontributin e autoriteteve përkatëse dhe statusin aktual të veprimeve të Programit të Kompensimit të Viktimave të parashikuar në korrik 2017 nga Ministria e Drejtësisë.

Qëllimi dhe përmbajtja e Manualit

Ky raport merr formën e një Manuali: asiron (synon) të mbledhë të gjitha dispozitat që lidhen me funksionin e Komisionit dhe t'i ndërlidhë ato me njëri-tjetrin, por më e rëndësishmja i paraqet ato në një kontekst operacional. Ajo që parashikohet si rezultat përfundimtar është një udhëzues gjithëpërfshirës i bazuar në një qasje më operationale dhe analizë të legjislacionit ekzistues, i cili do të ishte i dobishëm për të gjitha palët e përfshira në proceset e Kompensimit të Viktimave të Krimin, duke përfshirë përfituesit e mundshëm dhe profesionistët jo-ligjorë, nëpunësit publikë zyrtarët.

Fillimisht Komisioni, mandati i tij, detajet e themelimit dhe funksionimit si dhe parimet e tij udhëzuese diskutohen shkurtimisht. Në vazhdim për tu ndjekur janë prezentimi kolektiv i dispozitave në lidhje me të drejtat e viktimave, një analizë të afateve të aplikueshme, një listë

kontrolli për të gjithë dokumentacionin e kërkuar për të mbështetur një kërkesë dhe hapat proceduralë për të marrë informacione shtesë të cilat mund të jenë të nevojshme ose të rëndësishme për një aplikim i suksesshëm apo edhe i pranueshëm.

Pjesa kryesore e këtij Manuali është kapitulli 1.7, i cili synon të jetë një prezentim hap pas hapi i të gjitha proceseve të zbatueshme. Të gjitha aspektet procedurale të një kërkesë, që nga marrja e saj, deri në vlerësimin dhe njoftimin e aplikuesit lidhur me rezultatet e tij, klasifikohen në 9 hapa konsektiv të shoqëruara me një diagram që ofron kontekstin vizual në procedurën e përgjithshme.

Për kapitujt e saj të fundit, Manuali trajton tema më të specializuara ose teknike, të tilla si situatat Ndërkufitare, Mbrojtja e të Dhënave, Mbajtja e Dokumenteve dhe Aspektet Financuese të operacioneve të Komisionit .

Zhvillimi i këtij Manuali ishte gjithashtu në gjendje të ofrojë një kontekst të ndryshëm në pikëpamje të legjislacionit ekzistues, duke marrë parasysh gjithashtu mungesën e provave empirike në dispozicion për shqyrtimin e aplikacioneve për shkak të kohës së shkurtër të funksionimit të Komisionit. Shqyrtimi i kornizës ligjore nga një pikëpamje operacionale siguroi njohuri të dobishme për të vlerësuar në mënyrë kritike një institucion të sapo krijuar, pra Komisionin dhe veçoritë e tij. Rishikimi i të gjitha aspekteve procedurale nga fushëveprimi i një aplikuesi potencial ose një anëtari të Komisionit, çështjet potenciale që mund të lindin, mangësitë e mundshme dhe vështirësitë e mundshme si dhe sektorët ku ka hapësirë për racionalizim të mëtejshëm janë identifikuar dhe do të detajohen në një Raport Analizë dhe Rekomandime I cili do të përcjellë dhe plotësoj këtë Manual.

1. Komisioni për kompenzimin e viktimave të krimit

1.1 Përbërja e Komisionit dhe Sekretariatit

Anëtarët e Komisionit u emëruan më 10 Gusht 2016, me Vendimin e Qeverisë Nr. 10/104². Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë me statusin e mëposhtëm (Neni 23, pika 1, ligji Nr. 05/L-036):

1. një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, si kryetar i Komisionit, i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
2. një (1) prokuror i Prokurorisë së shtetit, i propozuar nga Këshilli Prokurorial;
3. një (1) anëtar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i propozuar nga radhët e anëtarëve të Komisionit përkatës për legjislacion;
4. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, anëtar, i propozuar nga ministri i Drejtësisë;
5. dy (2) anëtarë ekspertë mjekësor të licencuar në fushën e traumatologjisë dhe psikiatrisë, të propozuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës;
6. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar me përvojë në fushën e të drejtave të njeriut apo ofrimit të shërbimeve për viktimë, i propozuar nga organizatat e shoqërisë civile.

Prandaj, sipas dispozitave përkatëse të ligjit, pas propozimeve nga institucionet përkatëse, zgjedhja e anëtarëve të Komisionit qëndron në Qeverinë e Kosovës. Ligji nuk përfshin ndonjë standard për përzgjedhje, përveç eksperiencës në fushën e të drejtave të njeriut ose shërbimeve për viktimë dhe licencës në fushën e traumatologjisë dhe psikiatrisë për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe respektivisht, ekspertët mjekësorë.

Bazuar në Nenin 27 të Ligjit Nr. 05/L-036 lidhur me ofrimin e mbështetjes për Komisionin nga Ministria e Drejtësisë, Sekretariati është themeluar më 24 Maj 2017 sipas vendimit të Ministrisë Nr. 70 dhe aktualisht përbëhet nga tre anëtarë të stafit. Qëllimi i Sekretariatit është të sigurojë mbështetje teknike dhe administrative për anëtarët e Komisionit.

1.2 Kohëzgjatja e emërimit

Anëtarët e Komisionit shërbejnë për një mandat trevjeçar ndërsa kryesuesi për një mandat katërvjeçar (Neni 23, pika 2, ligji nr. 05/L-036). Ndërprerja e mandatit të një anëtari të Komisionit mund të bëhet sipas Nenit 24 §1, Ligji Nr. 05/L-036, në rastet e mëposhtme:

- në rast të vdekjes;

² Anëtarët e Komisionit janë: Nesrin Lushta, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, Kryetar; Bahri Hyseni, Prokuror i Prokurorisë së Shtetit, Anëtar; Nezir Cocaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Anëtar; Mentor Borovci, Ministria e Drejtësisë, Anëtar (duke zëvendësuar Mentor Borovcin, sipas Urdhrit të Qeverisë Nr. 05/145, 15.05.2017); Nazmie Ibishi, Dhoma e Mjekëve të Kosovës, Anëtar; Xhevat Gashi, Dhoma e Mjekëve të Kosovës, Anëtar; Behxhet Shala, KMDLNJ, Anëtar

- humbja e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkak të arsyeve mjekësore të vërtetuara;
- dështimi i vazhdueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë e Komisionit për më shumë se tre (3) muaj;
- pushimi i statusit mbi të cilin bazohet caktimi si anëtar;
- skadimi i mandatit;
- dorëheqje duke informuar Komisionin me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.

Anëtari i komisionit mund të shkarkohet para skadimit të mandatit nëse veprimet e tyre i bëjnë të padenjë për të kryer funksionin e tyre dhe në rastet kur kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të pandërgjegjshme dhe nëse janë të dënuar për vepër penale (Neni 24 §2, Ligji Nr. 05/L-036).

Rregullat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore lidhur me Vendimin e Gjyqtarit (Neni 67-72, Ligji Nr. 03/L-006 dhe Ligji Nr. 04/L-118) janë gjithashtu të zbatueshme për Anëtarët e Komisionit.

1.3 Proceset vendim-marrëse

Komisioni miraton rregullat e procedurës për funksionimin e tij (Neni 25 §4, Ligji Nr. 05/L-036). Vendimet mbi kërkesat për kompensim merren me shumicë votash (Neni 34 § 1, Ligji Nr. 05/L-036) gjatë mbledhjeve të thirrura nga Kryesuesi (Neni 25 §1, Ligji Nr. 05/L- 036) me të paktën 2/3 e anëtarëve të pranishëm (Neni 34 §3, Ligji Nr. 05/L-036).

Komisioni vendos për kërkesën brenda 90 ditëve nga pranimi i kërkesës së plotësuar (Neni 34 pika 4, ligji Nr. 05/L-036), e cila mund të pranohet, tërësisht ose pjesërisht, ose të refuzohet si e pabazuar (Neni 34 §2, Ligji Nr. 05/L-036).

Aplikacionet vlerësohen në bazë të standardit të dyshimit të arsyeshëm. Ligji më tutje shpjegon këtë standard si më poshtë: një aplikacion duhet të miratohet nëse autenticiteti i informacionit dhe fakteve të kërkuara dhe të konsideruara do të konsiderohej i mjaftueshëm për të bindur një vëzhgues objektiv. (Neni 13, UA (QRK) Nr. 01/2017).

2. Principet udhëzuese

Të gjitha autoritetet përkatëse duhet të sigurojnë që viktimat të trajtohen me (Neni 4, 1 dhe 2, Ligji Nr. 05/L-036):

- Profesionalizëm
- Respektimin e të drejtës së tyre për siguri
- Respektimin e të drejtës së tyre për dinjitet
- Respektimin e të drejtës së tyre për jetën private dhe familjare
- Njohjen e ndikimit negativ që ka krimi tek viktimat

- Respektimin e të drejtave të tyre në mënyrë jodiskriminuese, duke përfshirë, mos marrjen parasysh të statusit të tyre rezident.

3. Të drejtat e viktimës

Në vijim përfshihet një pasqyrë e të drejtave kryesore të viktimave që kanë të bëjnë me procedurën e kompensimit, të përcaktuara përmes dokumenteve relevante legjislative.

- Viktimat duhet të jenë të njoftuara në tërësi mbi të drejtat e tyre, mbi procedurat dhe procesin e shqyrtimit, lidhur me kufizimet dhe kriteret e nevojshme për aplikim dhe gjatë gjithë kohës do t'i ofrohen informatat e besueshme. (Neni 10, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Institucionet në kontakt me viktimat kanë detyrim t'i informojnë për të drejtën e tyre për kompensim. Për më tepër, institucionet shëndetësore dhe sociale, policia, prokuroria dhe gjykatat duhet të vendosin informatat përkatëse në një hapësirë publike (Neni 28, pika 1, ligji nr. 05 / L-036).
- Ministria e Drejtësisë në rast nevojë, do të ofrojë udhëzime të përgjithshme për parashtruesit e kërkesës. Udhëzimet do të përfshijnë informatat se si do të plotësohet aplikacioni dhe çfarë dokumentacioni mbështetës mund të jetë i nevojshëm. (Neni 28, pika 3, ligji nr. 05/L-036).
- Komisioni është i detyruar që në pajtim me legjislacionin në fuqi për qasje në dokumentet publike, t'iu ofroj qasje në evidence palëve dhe pjesëmarrësve në procedurën e kompensimit, duke marrë parasysh edhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. (Neni 7, §1, UA (QRK) Nr 02/2017)
- Viktima ka të drejtën të paraqesë kërkesë për kompensim nga i pandehuri në kontest civilo-juridik, në pajtim me legjislacionin në fuqi, përderisa kompensimi i caktuar nga gjykata në këtë kontest nuk përbën kompensim të dyfishtë për të njëjtin dëm. (Neni 8, 4, dhe Neni 10, §3, UA (QRK) Nr 01/2017)
- Pala e pakënaqur ndaj vendimit të Komisionit mund të iniciojë kontest administrativ në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi (Neni 34, §7, Ligji Nr. 05/L-036).

4. Format e aplikacioneve dhe Dokumentacionit Përkrasës

Tabela 1 më poshtë detajon informatat dhe kërkesat përkatëse të dokumentacionit mbështetës që duhet të ofrohen gjatë procesit të aplikimit sipas formularit përkatës të aplikimit dhe udhëzimeve për aplikantët e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë më 11 Maj 2017.

Tabela 1: Lista e kontrollit	
Informatat e Aplikacionit	Dokumente Përkrahëse
Informata rreth viktimës	Dokument identifikimi ose dëshmi për nënshtetësi ose vendbanim të përhershëm;
Informata rreth aplikuesit	Dokument identifikimi ose dëshmi për nënshtetësi ose vendbanim të përhershëm;
Përshkrimi i veprës penale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumenti ose konfirmimi i policisë që tregon se vepra penale është raportuar; 2. Vendimi përfundimtar i gjykatës; 3. Dëshmi se ekzekutimi i vendimit të gjykatës nuk ka qenë i suksesshëm ose se ekzekutimi i vendimit nuk ishte i mundur.
Lloji dhe shuma e kompensimit të kërkuar	--
Informata mbi dëmtimin e shëndetit, shqetësimin në shëndetin mendor dhe shpenzimet mjekësore	<p>Kompensimi për dëmtime të rënda fizike ose dëmtim të shëndetit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raportet mjekësore dhe diagnoza për lëndimin fizik të shkaktuar si rezultat i veprës penale 2. Çdo dokument tjetër që provon plagën ose dëmtimin, kohëzgjatjen dhe shkallën e lëndimit. 3. Raporti mjekësor për trajtimin e nevojitur për viktimën, i cili specifikon kohëzgjatjen dhe shumën totale të shpenzimeve të pritura të trajtimit mjekësor. 4. Faturat për trajtim mjekësor, ekzaminime mjekësore, operacione, ilaçe, hospitalizime etj.
	<p>Kompensim për shqetësime serioze të shëndetit mendor</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporte nga Psikiatri ose Psikologu. 2. Raporte ose diagnoza nga Psikiatri ose Psikologu që vërteton shqetësim serioz për shëndetin mendor. 3. Raporte nga Psikiatri ose Psikologu mbi trajtimin e nevojshëm për viktimën, i cili përcakton kohëzgjatjen dhe numrin e seancave të nevojshme terapeutike, si dhe shpenzimet e pritura të trajtimit. 4. Faturat për trajtim mjekësor dhe ilaçet e nevojshme për shërim. 5. Fotografji në rastet kur shqetësimi ndaj shëndetit mendor erdhi si pasojë e shpërftyrimit. 6. Dokumentet tjera relevante.

	<p>Kompensimi i dëmeve për pajisjet e shkatërruara mjekësore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dëshmia e pagesës (fatura) e pajisjes medicinale të blerë e që është shkatërruar si rezultat i veprës penale. 2. Fotografi e pajisjes ose dëshmia e llojit të pajisjes.
Informata rreth humbjes së kapacitetit për punë ose të drejtës për mirëmbajtje	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti mjekësor për lëndimin që rezultoi nga vepra penale si dhe shkalla dhe kohëzgjatja e humbjes së kapacitetit. 2. Dëshmi për numrin e ditëve të mungesës nga puna dhe humbjes së pagave. 3. Letër nga punëdhënësi që konfirmon mungesën tuaj nga puna për shkak të lëndimeve të rënda si rezultat i veprës penale. 4. Detajet mbi biznesin nëse janë të vetëpunësuar. 5. Deklarata e bankës ose dëshmi të tjera të besueshme që tregojnë se pagat janë marrë. 6. Dokument që tregon se sa gjatë do të mungoni nga puna për shkak të humbjes së kapacitetit për të punuar si rezultat i veprës penale. 7. Dokumentet që tregojnë se ju jeni ofruesi kryesor i familjes dhe një çertifikatë e bashkësisë familjare. 8. Dokumentet e identifikimit të personave në ngarkim.
Informata rreth vartësit	Certifikatën e bashkimit familjar dhe/ose çdo dokument që dëshmon pozitën e tyre të varur
Shpenzimet e Funeralit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Faturat/dëshimtë e pagesave të bëra për shpenzimet e funeralit. 2. Certifikata e vdekjes.
Shpenzimet Procedurale	Faturat/vërtetimet e pagesave të bëra për të marrë dokumente për të paraqitur një kërkesë për kompensim.
Kompensimi sigurohet në procedura të tjera	Dëshmia e kompensimeve të pranuar nga burime të tjera, të tilla si gjykatat/mbrojtja, sigurimi shëndetësor, ose të tjera.
Deklarata dhe vërejtje	--
Nënshkrimi	--
Dokumente shtesë	Përveç aplikimit të kërkuar dhe dokumentacionit mbështetës, aplikanti mund të përfshijë çdo dokument tjetër që konsideron të rëndësishëm për mbështetjen e aplikacionit (Neni 4, 6, UA (QRK) Nr. 01/2017).
Shënime të rëndësishme – Përjashtimet	
Gjuha e aplikacioneve	Aplikacionet e viktimave nacionale mund të plotësohen në gjuhën shqipe apo serbe.

	Aplikacionet e viktimave në situata jashtë kufinjëve mund të plotësohen edhe në anglisht (Neni 30, pika 7, ligji nr. 05 / L-036).
Dokumentet përkrahëse në gjuhët e tjera	Dokumentet në një gjuhë tjetër përveç anglishtes duhet të shoqërohen me një përkthim të çertifikuar në gjuhën shqipe, serbe ose angleze (Neni 32, pika 4, Ligji Nr. 05 / L-036).
Dokumentet përkrahëse në gjuhët e tjera në rastet e viktimave të trafikimit	Në rastet e një viktime të huaj të trafikimit, dokumentet janë të pranueshme në çdo gjuhë. Në këto raste, Ministria e Drejtësisë merr përsipër detyrimin e përkthimit të dokumenteve (Neni 24, pika 3, UA (QRK) Nr. 01/2017).
Dokumentet e transmetuara ndërmjet autoriteteve në situatat ndërkufitare	Të gjitha aplikacionet dhe dokumentet e transmetuara ndërmjet autoriteteve në situatat ndërkufitare përjashtohen nga vërtetimi ose ndonjë formalitet ekuivalent (Neni 32, pika 5, Ligji Nr. 05 / L-036).
Dokument identifikimi ose dëshmi për nënshtetësi ose vendbanim të përhershëm	Për viktimat e trafikimit që nuk posedojnë dokumente identifikimi me dëshmi të shtetësisë, ky parakusht është i plotësuar kur raporti i policisë identifikon aplikantin si të trafikuar, shtetësinë e tij/saj dhe se ai ose ajo nuk ka dokumente identifikimi. (Neni 32, pika 2, ligji nr. 05 / L-036)

5. Kërkesat për Informata Shtesë

Ofrimi i informatave shtesë dhe dokumentacionit mbështetës në mbështetje të aplikacionit do të kërkohej, nëse është e nevojshme, në rastet e mëposhtme:

- Aplikime jo të plota ose të pakuptueshme:
 - Në rastet e aplikimeve të pakompletuara ose të pakuptueshme, aplikuesi ka të drejtë të korrigjojë mangësinë brenda një afati të caktuar nga Komisioni, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë. (Neni 33, §2 & 3, Ligji Nr. 05 / L-036)
- Referimi i kërkesës nga Gjykata:
 - Në rast të referimit të kërkesës nga Gjykata, Komisioni mund të kërkojë nga aplikanti informata shtesë, të cilat nuk janë paraqitur nga gjykata. (Neni 5, §3, UA (QRK) Nr. 01/2017)
- Dokumentet shtesë që nuk janë në dispozicion në kohën e aplikimit:
 - Aplikuesit i jepet mundësia për të plotësuar kërkesën me dokumente shtesë në mbështetje të aplikacionit, të cilat nuk ishin të disponueshme kur aplikacioni ishte dorëzuar, derisa të merret një vendim përfundimtar. (Neni 6, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017)
- Intervistat ose raportet me shkrim nga zyrtarët:

- Kur është e nevojshme, Komisioni mund të intervistojë ose të kërkojë një raport me shkrim nga zyrtarët përkatës të përfshirë në procesin penal në një rast të veçantë dhe që mund të ketë njohuri për ndikimin e krimit ndaj viktimës. (Neni 25, pika 2, ligji nr. 05/L-036)
- Këmbimi i informatave me autoritete kompetente të vendeve të tjera:
 - Ministria e Drejtësisë, kurdo që është e nevojshme, do të sigurojë shkëmbimin e informatave me autoritetet kompetente të vendeve të tjera, sipas rregullave të vendeve përkatëse kompetente për kryerjen e detyrave në procedurat e kërkesave për kompensim. Ministria e Drejtësisë do të japë ndihmë dhe të kërkojë zgjidhje adekuate në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji në situatat ndërkuftare. (Neni 28, pika 4, ligji nr. 05 / L-036)
- Informatat nga Policia:
 - Me kërkesë të Komisionit, Policia do t'i ofrojë informata Komisionit për vepra penale të dhunshme nga të cilat viktima ka vuajtur. (Neni 28, pika 5, ligji nr. 05 / L-036)
- Të dhënat nga autoritetet dhe organet publike:
 - Administratorët e bazave të të dhënave personale, autoritetet shtetërore, autoritetet e bashkësive lokale vetëqeverisëse dhe organet që ushtrojnë kompetenca publike në posedim të të dhënave për rrethanat dhe faktet e rëndësishme për vendimmarrje, duhet t'i transferojnë të dhënat e lartpërmendura Komisionit , sipas kërkesës me shkrim. (Neni 35, pika 1, ligji nr. 05 / L-036)
- Të dhënat nga individët:
 - Me kërkesë me shkrim të Komisionit, të dhënat për rrethanat dhe faktet e rëndësishme për vendimmarrje mund të dorëzohen vullnetarisht në Komision nga individë që posedojnë të dhënat. (Neni 35, §2, Ligji Nr. 05 / L-036)

6. Afatet kohore për dorëzimin e Aplikacioneve

Afati kohor për dorëzimin e aplikacionit në të gjitha rastet e aplikueshme është paraqitur në tabelën e mëposhtme (Tabela 2). Data e fillimit për afatet e mëposhtme është vendosur si data kur Programi i Kompensimit të Viktimave të Krimit u bë funksional, gjegjësisht më 11 maj 2017.

Table 2: Afatet për dorëzimin e aplikacionit	
Rasti	Afati
Fëmija viktimë e trafikimit dhe kryerësi është i panjohur 3 muaj pas zbulimit ose	Jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data kur u raportua vepra e fundit kriminale, e cila shkaktoi kërkesën për kompensim.

raportimit të krimit	(Neni 31, pika 1, ligji nr. 05 / L-036)
Viktima e huaj e trafikimit dhe kryerësi është i panjohur 3 muaj pas zbulimit ose raportimit të krimit	Jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data kur u raportua vepra e fundit kriminale, e cila shkaktoi kërkesën për kompensim. (Neni 31, pika 1, ligji nr. 05 / L-036)
I pandehuri ka ofruar vetëm kthim të pjesshëm	Brenda gjashtë (6) muajve nga marrja e vendimit përfundimtar. (Neni 31, pika 2, ligji nr. 05 / L-036)
Kanë kaluar dy (2) vjet që nga zbulimi i veprës penale dhe nuk ka pasur aktakuzë;	Afati kohor prej gjashtë (6) muajsh fillon nga skadimi i afatit dyvjeçar. (Neni 31, pika 3, ligji nr. 05 / L-036)
I pandehuri lirohet pasi ai ishte personi i gabuar, ndërsa kryerësi mbetet i panjohur;	Brenda gjashtë (6) muajve nga marrja e vendimit përfundimtar. (Neni 31, pika 2, ligji nr. 05 / L-036)
Gjykata ka vendosur që i pandehuri në çështjen penale nuk është penalisht përgjegjës.	Brenda gjashtë (6) muajve nga marrja e vendimit përfundimtar. (Neni 31, pika 2, ligji nr. 05 / L-036)
I pandehuri në atë rast penal është i vdekur	Brenda gjashtë (6) muajve nga marrja e vendimit përfundimtar. (Neni 31, pika 2, ligji nr. 05 / L-036)
Ekzekutimi i procedurës gjyqësore të parashikuar për të paditurin për të paguar kthimin nuk është e mundur ose kur për arsye të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, e njëjta gjë nuk mund të ekzekutohet	Brenda gjashtë (6) muajve nga marrja e vendimit përfundimtar. (Neni 31, pika 2, ligji nr. 05 / L-036)
Viktima për shkak të lëndimeve të tij fizike ose ndonjë arsye tjetër të justifikuar që nuk e lejon atë të depozitojë dhe të aplikojë, nuk paraqet kërkesën e tij deri në afatin e parashtruar në §2 (kthimi i pjesshëm) dhe 3 (pa aktakuzë pas dy vjet)	Jo më vonë se tre (3) muaj nga dita kur kanë pushuar së ekzistuari arsyet për të cilat ai nuk ka mundur të paraqesë kërkesën. (Neni 31, pika 4, ligji nr. 05 / L-036)
Viktima e krimit që për shkak të lëndimeve të tij fizike ose ndonjë arsye tjetër të justifikuar që nuk e lejon atë të depozitojë dhe të aplikojë është nën moshën tetëmbëdhjetë (18)	Jo më vonë se tre (3) muaj nga dita kur viktima mbush tetëmbëdhjetë (18) vjet. (Neni 31, pika 5, ligji nr. 05 / L-036)

7. Hapat Procedural për vlerësimin e kërkesës

Hapi 1. Pranimit i aplikacionit

Aplikacioni dhe dokumentacioni përkatës mund të merren në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- direkt (Neni 5, §1, UA (QRK) Nr 01/2017)
- me postë (Neni 5, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017)
- përmes e-mailit (Neni 5, §1, UA, (QRK) Nr 01/2017)
- kërkesat e parashtruara nga Gjykata (Neni 29, pika 4, ligji nr. 05 / L-036)

Hapi 2. Regjistrimi i Aplikacionit

Pas pranimit të kërkesës dhe mbështetjes në dokumentacion, të gjitha të dhënat relevante regjistrohen në regjistrin e posaçëm (Neni 7, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017) (për më shumë informata shih seksionin 1.11).

Hapi 3. Njoftimi i aplikuesit

Kur një aplikim është pranuar, aplikanti njoftohet dhe pajiset me numrin përkatës të referencës (Neni 7, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017). Në rastet kur aplikimi dorëzohet me e-mail, konfirmimi i pranimit jepet nëpërmjet një njoftimi automatik me e-mail, i cili konfirmon marrjen e e-mailit duke treguar edhe datën dhe orën. (Neni 7, §3, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Hapi 4. Shqyrtimi preliminar

Shqyrtimi preliminar i aplikacionit bazohet në kriteret ne vijim:

1. A është aplikacioni i kompletuar dhe gjithëpërfshirës?
 - Nëse aplikacioni është i paplotë ose i papërshtatshëm, duhet të bëhet një kërkesë për informata shtesë ose rregullim të mangësive brenda një afati kohor të caktuar (jo më pak se 30 ditë) (shih gjithashtu pjesën 1.5) (Neni 33, §2 & 3, Ligji Nr. 05 / L-036).
 - Nëse aplikanti nuk arrin të japë informata ose të korrigjojë mangësinë brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet (Neni 33, §2, Ligji Nr. 05 / L-036).
 - Sidoqoftë, aplikuesit do t'i jepet mundësia për të plotësuar dokumentet shtesë në mbështetje të kërkesës, të cilat nuk ishin të disponueshme kur aplikacioni ishte dorëzuar, derisa të merret një vendim përfundimtar. (Neni 6, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).
2. A nevojiten më shumë informata, të dhëna apo dokumente nga burime të tjera?

- Në rastet kur më shumë informata, të dhëna ose dokumente janë të nevojshme për vlerësimin e një aplikacioni, mund të bëhen kërkesa përkatëse për individët ose autoritetet përkatëse (shih gjithashtu pjesën 1.5).
3. A përputhet dorëzimi i aplikacionit me afatet kohore relevante?
- Aplikacionet që nuk janë dorëzuar në kohë sipas dispozitave përkatëse do të refuzohen (Neni 33, §1, Ligji Nr. 05 / L-036) (shih gjithashtu seksionin 1.6).

Hapi 5. Vlerësimi kryesor

Vlerësimi kryesor i kërkesave për kompensim bëhet sipas kritereve të mëposhtme të pranueshmërisë:

1. A është aplikuesi përfutës i kompensimit?
 - Të përmendurit mëposhte kanë të drejtën e kompensimit (Neni. 12, §1, AI (QRK) Nr 01/2017):
 - Viktimë e veprave penale të kompensuara sipas Ligjit (shiko po ashtu pikën 2 më poshtë);
 - I varur nga viktima
2. A është krimi, krim i dhunshëm i kompensuar? (Neni. 6 Ligji Nr. 05/L-036)
 - vrasje;
 - trafikimi i Personave;
 - përdhunim;
 - abuzimi seksual i fëmijëve;
 - Veprat penale që bien brenda përkufizimit të dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.
 - Përfundim: Përveç këtyre krimeve, Komisioni mund të shqyrtojë dhe të vendosë për kërkesat e tjera të individëve të cilët pretendojnë se janë viktima të krimeve të tjera të dhunshme, të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe pasojave të shkaktuara mund të arsyetojnë kompensimin sipas këtij ligji, Nëse viktima është një viktimë e rrezikuar.
3. A ka të drejtë viktima qasje të menjëhershme në kompensim? (Neni. 9 Ligji Nr. 05/L-036)
 - Personi është fëmijë ose viktimë e huaj e trafikimit dhe kryerësi mbetet i panjohur për tre (3) muaj nga zbulimi ose raportimi i krimit.
 - Viktima e huaj e trafikimit duhet të bashkëpunojë në mënyrë të arsyeshme me autoritetet në hetimin dhe ndjekjen e kryerësit të krimit.

- Nëse brenda afatit kohor të parashikuar për plotësimin e aplikacionit, viktimat e huaj e trafikimit është brenda territorit të Republikës së Kosovës, e njëjta mund të paraqesë një kërkesë drejtpërdrejtë tek Komisioni ashtu si viktimat e tjera vendore.
4. A i plotëson aplikuesi kushtet formale? (Neni. 7 Ligji Nr. 05/L-036)
- qytetar ose banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;
 - qytetar i çdo vendi me të cilin Republika e Kosovës ka reciprocitet; ose
 - qytetar i një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian.
 - Përjashtim: Qytetarët e huaj, përveç viktimave që kanë të drejtën e qasjes së menjëhershme në kompensim (shih gjithashtu pikën 3 më lart dhe Nenin 9 të Ligjit Nr. 05/L-036), mund të paraqesin kërkesën për kompensim përmes autoriteteve të tyre lokale (UA (QRK) Nr 01/2017).
5. A i plotëson krimi kushtet materiale? (Neni. 8 Ligji Nr. 05/L-036)
- dënohet me minimum një vit burgim;
 - është kryer në territorin e Republikës së Kosovës;
 - është zbuluar dhe raportuar në organin kompetent dhe është trajtuar si vepër penale;
 - nuk është kryer me neglizhencë;
 - ka rezultuar me vdekjen e viktimës, lëndime të rënda trupore, dëmtime serioze të shëndetit ose shqetësime serioze në shëndetin mendor të viktimës;
 - viktimat ka të shkaktuara dëme të njohura nga ky ligj si pasojë e krimit; dhe
 - Aplikuesi nuk është në gjendje të marrë kompensim përmes sigurimit shëndetësor ose burimeve të tjera.
6. A ka kërkuar aplikuesi fillimisht kompensim nga i pandehuri?
- Para aplikimit për kompensim sipas këtij ligji, aplikanti është i detyruar të kërkojë fillimisht kompensimin nga i pandehuri në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, me përjashtim të rasteve të mëposhtme (Neni 10, §1, ligji nr. 05 / L-036).
 - Përjashtime: personi është fëmijë ose viktimë e huaj e trafikimit dhe kryerësi mbetet i panjohur për tre (3) muaj nga zbulimi ose raportimi i krimit (Neni 9, pika 1, ligji nr. 05/L-036) .
 - Në rastet kur i pandehuri siguron vetëm një kthim të pjesshëm të viktimës, viktimat ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për kompensim shtesë nga programi për kompensimin e viktimës (Neni 10, Ligji Nr. 05/L-036)
7. A ka pamundësi për të marrë kompensimin nga i pandehuri?

- Aplikuesi ka të drejtë të kërkojë kompensim, nëse demonstron se kompensimi nuk mund të merret për shkak të rrethanave të mëposhtme (Neni 11, Ligji Nr. 05 / L-036):
 - nëse një person ishte viktimë, por kanë kaluar dy (2) vjet që nga zbulimi i veprës dhe nuk ka pasur aktakuzë;
 - nëse përcaktohet se personi ishte viktimë, por i pandehuri lirohet pasi ai ishte personi i gabuar, ndërsa kryerësi mbetet i panjohur;
 - nëse Gjykata ka vendosur që i pandehuri në çështjen penale nuk është penalisht përgjegjës;
 - nëse i pandehuri në atë rast penal është i vdekur;
 - nëse procedura e gjykatës për të paditurin për të paguar kthimin nuk është e mundur ose kur për arsye të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, e njëjta gjë nuk mund të ekzekutohet.
8. A është duke kërkuar viktimia kompensimin për llojet e dhura sipas akteve relevante ligjore?
- Viktimia mund të kërkojë kompensim mbi lëndimet, dëmtimet dhe shpenzimet, si në vijim (Neni. 12, §2, UA (QRK) Nr 01/2017):
 - lëndime të rënda fizike ose dëmtim të shëndetit;
 - shqetësime serioze për shëndetin mendor;
 - humbja e kapacitetit për punë dhe humbja e vetë-mbajtjes.
 - shpenzimet mjekësore dhe spitalore;
 - dëmtime nga shkatërrimi i pajisjeve mjekësore;
 - shpenzimet procedurale për plotësimin e kërkesës për kompensim.
 - Të varurit mund të kërkojnë kompensim për shpenzimet në vijim (Neni. 12, §3, UA (QRK) Nr 01/2017):
 - Kompensimi për vuajtjen e humbjes së një anëtari të familjes;
 - humbja e së drejtës për mirëmbajtje;
 - shpenzimet mjekësore dhe spitalore;
 - shpenzimet e varrimit;
 - Shpenzimet procedurale për paraqitjen e kërkesës për kompensim.
 - kompensimi në situata sipas Nenit 22, § 2 të Ligjit kur Komisioni tashmë ka vendosur të kompensojë viktimën dhe transferimi nuk është ekzekutuar. Më specifike (Neni. 22, Ligji Nr. 05/L-036):
 1. Në rastet kur një aplikant vdes nga shkaqet që nuk kanë lidhje me krimin e dhunshëm pas paraqitjes së kërkesës, anëtari i familjes së të ndjerit ka të drejtë për kompensim nëse kushtet e mëposhtme janë plotësuar kumulativisht:

- 1.1. Nëse përpara se personi të vdesë, Komisioni i lëshoi një vendim për dhënien e kompensimit, por shpërblimi i kompensimit nuk është transferuar akoma në llogarinë e viktimave dhe;
 - 1.2. Nëse anëtar i familjes ishte financiarisht i varur nga i vdekuri dhe nuk ka burime të tjera të mirëmbajtjes.
9. A kanë pranuar viktima apo i pandehuri kompensim për të njëjtin dëmtim?
- Viktimat dhe vartësit e tyre nuk mund të marrin kompensim të dyfishtë për të njëjtin dëm (Neni 4, pika 4, Ligji Nr. 05/L-036, Neni 8, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Hapi 6. Vlerësimi i llojeve të dëmtimit

Pas verifikimit të kriterëve kryesorë të pranueshmërisë, aplikacioni vlerësohet sipas kriterëve përkatëse për llojin e dëmeve të kërkuara bazuar në standardin e dyshimit të arsyeshëm (Neni 13, UA (QRK) Nr. 01/2017):

- Aplikacioni duhet të miratohet nëse autenticiteti i informatave dhe fakteve të kërkuara dhe të konsideruara do të konsideroheshin të mjaftueshme për të bindur një vëzhgues objektiv

Në procesin e llogaritjes së shumës për kompensim, do të merren parasysh heqja dorë nga taksat mjekësore për kategori të caktuara të viktimave siç përcaktohet nga protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë (Neni 12, pika 3, Ligji Nr. 05 / L-036).

(A) Kompensimi për plagë serioze fizike apo dëmtime të shëndetit

Rastet e pranueshme:

- Kompensimi për lëndime serioze dhe dhimbje të shoqëruara (Neni. 13, §1, Ligji Nr. 05/L-036). Si lëndime serioze konsiderohen ato në vijim (Neni. 13, §2, Ligji Nr. 05/L-036):
 - plagë që zgjasin më shumë se gjashtë (6) javë, të cilat rezultojnë në paaftësi për të punuar ose për të kryer detyrat e përditshme;
 - lëndimet me pasoja afatgjata ose të përhershme të dukshme ose funksionale;
 - lëndimet të cilat ishin objektisht kërcënuese për jetën.

Rastet e pa-pranueshme:

- Lëndimet fizike që kanë rezultuar vetëm në dëmtim të përkohshëm (Neni 13, pika 1, ligji nr. 05 / L-036)

- Lëndime fizike për të cilat shëndeti i viktimës është i zhvlerësuar përkohësisht në një masë më të vogël (Neni 13, pika 1, ligji nr. 05 / L-036)

Përcaktimi i kompenzimit:

- Niveli i dhimbjeve bazuar në dokumentet e ofruara, përcaktohet duke marr në konsideratë (Neni. 13, §3, Ligji Nr. 05/L-036):
 - Rrethanat e rastit;
 - Shkalla e dhimbjes së shkaktuar nga dëmtimi ose dëmtimi i shëndetit;
 - Kohëzgjatja e dhimbjes;
 - Dhe sipas parimit të kompenzimit të drejtë monetar.

Shuma e kompenzimit:

- Bazuar në ato më lartë shuma e kompenzimit përcaktohet si (Neni 13, §3, Laë No. 05/L-036):
 - Deri në një mijë e pesëqind (1500) Euro për raste të rënda të moderuara;
 - Deri në tre mijë (3.000) Euro për raste serioze;
 - Deri në shtatë mijë (7,000) Euro për raste jashtëzakonisht të rënda.

Shuma maksimale:

- Shtatë mijë (7,000) Euro.

(B) Kompensimi për shqetësime serioze të shëndetit mendor

Rastet e pranueshme:

- Lëndime psikologjike të shkaktuara nga një vepër e dhunshme e rëndë që mund të konstatohet mjekësisht nga një psikiatër ose psikolog (Neni 14, §1, Ligji Nr. 05 / L-036).
- Çrregullimi është në një shkallë të tillë që ndikon në aktivitetet e rregullta të viktimës ose gjendjes së tyre psikologjike për një periudhë të zgjatur (Neni 14, pika 2, ligji nr. 05 / L-036).
- Kompensimi për shqetësime serioze të shëndetit mendor sipas këtij ligji, nuk zëvendëson kompensimin jo-material të dëmit që viktima mund ta realizojë në procedurat civile-ligjore (Neni 15, pika 1, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Rastet e pa-pranueshme:

- Paaftësi ose shqetësim i përkohshëm ose situata të tjera të ngjashme (Neni 14, pika 2, Ligji nr. 05/L-036).

Përcaktimi i kompenzimit:

- Kompensimi për çrregullime serioze për shëndetin mendor përcaktohet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme (Neni 14, pika 3, ligji nr. 05 / L-036):
 - Rrethanat e rastit;
 - Niveli dhe kohëzgjatja e ankthit dhe lloji i lëndimeve dhe
 - Çdo faktor tjetër përkatës.
 - Përfundim: Viktimat e dhunës në familje, fëmijët e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore konsiderohen se kanë përmbushur kriteret e mësipërme për të qenë të pranueshëm për kompensim (Neni 16, pika 1, UA (QRK) Nr. 01/2017)
- Çrregullimi i shëndetit mendor konsiderohet serioz kur është shkaktuar si pasojë e (Neni 14, pika 4, Ligji nr. 05 / L-036):
 - Dëmtimi i lirisë
 - Shkelja e integritetit seksual
 - Shpërftyrimi
 - Tortura të vazhdueshme
 - Lëndime të tjera të cilat mund të kenë ndikim në gjendjen, sjelljen dhe personalitetin e viktimës.
- Aplikuesi ofron:
 - Dokumentacioni që konstaton se shkak i shqetësimit është pasojë e veprimeve të parashikuara më lart në paragrafin 4 të Nenit 14 të Ligjit (Neni 15, §3.1, UA (QRK) Nr. 01/2017).
 - Diagnoza e mjekut specialist dhe faturat përkatëse për trajtimin mjekësor dhe ilaçet e nevojshme për të rivendosur shqetësimin sipas këtij Neni (Neni 15, §3.2, UA (QRK) Nr. 01/2017).
 - Në rastet kur shqetësimi rezulton si pasojë e shpërftyrimit, aplikuesi, përveç asaj më sipër, mund të sigurojë gjithashtu një fotografi të viktimës së marrë para dorëzimit të kërkesës për kompensim (Neni 15, §4, UA (QRK) Nr 01/2017).
 - Përfundim: Viktimat e dhunës në familje, fëmijët e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kompensohen në bazë të shkallës së dëmit të shkaktuar deri në shumën maksimale të lejuar, pa u kërkuar të ofrojnë dëshmi në asnjë rast, vetëm dëshmi për shpenzimet rrjedhëse (Neni 16, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Shpenzimet e kompenzueshme:

- Vetëm shpenzimet aktuale të dokumentuara nga kërkuesi për korrigjimin e gjendjes së rënduar të shëndetit mendor (Neni 15, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Kalkulimi i kompenzimeve:

- Shuma e kompensueshme llogaritet sipas listës së çmimeve për shërbimet mjekësore nën sistemin e kujdesit shëndetësor publik të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë (Neni 14, pika 5, Ligji nr. 05 / L-036).
- Në rastet kur viktimat trajtohet në institucionet private shëndetësore, lista e çmimeve të Ministrisë së Shëndetësisë mund të shërbejë si udhërrëfyes për të vendosur mbi shumën e kompensimit, të lejuar deri në shumën maksimale të paraparë me ligj (Neni 15, 5, UA (QRK) Nr 01/2017).

Shuma maksimale:

- Pesë mijë (5,000) Euro (Neni. 14, §5, Ligji Nr. 05/L-036).

(C) Kompensimi për humbjen e të afërmit

Rastet e Pranueshme :

- Çrregullime serioze të shëndetit mendor për shkak të humbjes së një të afërmi të ngushtë (Neni. 14, §6, Ligji Nr. 05/L-036).

Proceset për përcaktimin e kompensimit, shpenzimet e kompensueshme dhe llogaritjen e kompensimit janë ato që aplikohen për kompensimin për shqetësim serioz të shëndetit mendor të përshkruar më lart në seksionin B (Neni 20, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Shuma maksimale:

- Tre mijë (3,000) Euro (Neni. 14, §6, Ligji Nr. 05/L-036).

(D) Kompensimi për humbjen e aftësisë për të punuar dhe humbjen e vetë-mbajtjes

Rastet e Pranueshme :

- Humbja e kapacitetit për punë: Një viktimë që kërkon kompensim për humbjen e pagave për shkak të humbjes së aftësisë për të punuar si rezultat i lëndimeve të shkaktuara nga krimi (Neni 15, pika 1, ligji nr. 05 / L-036)
- Humbja e vetëmbajtjes: Një i varur që kërkon kompensim për humbjen e vetëmbajtjes në rastet kur viktimat vdekur ishte kujdestari kryesor i aplikantit (Neni 15, pika 2, ligji nr. 05 / L-036).
- Rastet speciale:
 - Kompensimi sipas këtij lloji të dëmeve nuk e përjashton aplikantin nga kompensimi sipas llojit të dëmeve të tjera (Neni 15, pika 5, ligji nr. 05 / L-036)
 - Nëse një viktimë është kompensuar më parë nga Komisioni për humbjen e kapacitetit të punës, vartësit e tyre mund të aplikojnë vetëm për kompensim për humbjen e vetëmbajtjes nëse shuma e dhënë në të dyja rastet nuk e tejkalon shumën maksimale të parashikuar nga Ligji (Neni 21 , §3, UA (QRK) Nr 01/2017)

- Më shumë se një vartës financiar i një viktime mund të kompensohen, përderisa shuma e kompensimit kumulativ për të gjithë personat në ngarkim nuk duhet të tejkalojë shumën e përgjithshme të paraparë me ligj (Neni 21, pika 3, UA (QRK) Nr. 01 / 2017).

Përcaktimi i kompenzimit:

- Lëndimi ishte aq serioz saqë shkaktoi humbjen e kapacitetit për punë (Neni 17, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017), siç dëshmohet nga dokumentacioni i mëposhtëm (Neni 17, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017):
 - Raporti i mjekut mbi dëmtimin që rezulton nga vepra penale dhe niveli dhe kohëzgjatja e paaftësisë;
 - Historia e punës së viktimës:
 - Në rast se kjo nuk mund të sigurohet nga viktimja, mund të sigurohet deklarata bankare ose dëshmi të tjera të besueshme që tregojnë pagat e marra nga viktimja
 - Nëse viktimja ishte i vetëpunësuar, detajet mbi biznesin.
- I varuri siguron dëshmi të mjaftueshme që dëshmojnë varësinë financiare nga viktimja në përputhje me ato më sipër (Neni 21, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Kalkulimi i kompenzimit:

- Shuma e kompensueshme llogaritet si një shumë e vetme jo më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) Euro në muaj, me datën e fillimit të ditës kur është shkaktuar dëmi dhe shumëzohet me numrin e muajve që aplikuesi pritet të mbetet i paaftë për punë (Neni 15, pika 3, ligji nr. 05 / L-036).

Shuma maksimale:

- Tre mijë (3,000) Euro (Neni. 15, §4, Ligji Nr. 05/L-036).

(E) Kompensimi për shpenzime mjekësore dhe hospitalizim

Rastet e Pranueshme :

- Të varurit gjithashtu duhet të aplikojnë për kompensim për shpenzimet mjekësore dhe shtrimin në spital, nëse viktimja vdes përpara paraqitjes së kërkesës dhe kur vetë i varuri ka paguar për këto shpenzime (Neni 23, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017)

Përcaktimi i kompenzimit:

- E drejta për këtë lloj kompensimi përcaktohet në bazë të listës së çmimeve për shërbimet mjekësore nën sistemin e kujdesit shëndetësor publik të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë (Neni 16, pika 1, ligji nr. 05 / L-036).

Shpenzimet e kompenzueshme:

- Vetëm shpenzimet e dokumentuara nga aplikanti për shërbime mjekësore, hospitalizime dhe ilaçe (Neni 18, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017) të cilat nuk ofrohen falas nga institucionet shëndetësore (Neni 18, pika 2, UA (QRK) Nr 01/2017)

Kalkulimi i kompenzimit:

- Shuma e kompenzimit llogaritet sipas listës së çmimeve për shërbimet mjekësore nën sistemin e kujdesit shëndetësor publik të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë (Neni 16, pika 1, ligji nr. 05 / L-036).
- Në rastet kur viktimat trajtohet në institucionet private shëndetësore, lista e çmimeve të Ministrisë së Shëndetësisë mund të shërbejë si udhërrëfyes për të vendosur mbi shumën e kompenzimit, të lejuar deri në shumën maksimale të paraparë me ligj (Neni 18, 2, UA (QRK) Nr 01/2017; Neni 15, pika 5, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Shuma maksimale:

- Pesë mijë (5,000) Euro (Neni. 16, §2, Ligji Nr. 05/L-036).
- Përjashtim: në rastet e votimit unanim të anëtarëve të Komisionit, shuma maksimale nuk do të tejkalojë Dhjetë mijë (10,000) Euro (Neni. 16, §2, Ligji Nr. 05/L-036).

(F) Kompensimi i dëmtimeve nga shkatërrimi i pajisjeve mjekësore

Rastet e Pranueshme :

- Rimbursimi për çdo pajisje medicinale të cilat janë të nevojshme për shëndetin ose cilësinë e jetës (Neni 19, paragrafi 1, UA (QRK) Nr. 01/2017) dhe të cilat janë dëmtuar nga krimi i dhunshëm i qëllimshëm që rezultoi me lëndimin e viktimës (Neni 18, pika 1, ligji nr. 05 / L-036).

Shpenzimet e kompenzueshme përfshijnë, por nuk limitohen në (Neni. 19, §2, UA (QRK) Nr 01/2017):

- pajisjet e dëgjimit
- karrige me rrota (karroca invalidore)
- syza me dioptri
- proteza ortopedike
- proteza dentare
- pajisje të tjera që konsiderohen të nevojshme nga Komisioni.

Përcaktimi i kompensimit:

- Për qëllime të kompensimit termi "cilësia e jetës" nënkupton standardin e mirëqenies shëndetësore të një individi" (Neni 19, pika 3, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Nëse pajisja(et) e përmendur është blerë nga aplikanti, duhet të sigurohet dëshmi përkatëse e pagesës (Neni 19, pika 4, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Kalkulimi i kompensimit:

- Shuma e kompensueshme bazohet në çmimin e arsyeshëm për pajisjen e dëmtuar (Neni 19, pika 4, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Shuma maksimale:

- Tre mijë (3,000) Euro (Neni. 18, §2, Ligji Nr. 05/L-036)

(G) Kompensimi i shpenzimeve të funeralit

Rastet e Pranueshme :

- Vdekja e viktimës rezultoi nga një krim i kompensueshëm (shih Nenin 6, Ligji Nr. 05 / L-036) (Neni 22, pika 1, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Shpenzimet e varrimit i kompensohen anëtarit të familjes së aplikuesit që paguan funeralin (Neni 17, §1, Ligji nr. 05 / L-036, Neni 22, pika 1, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Zbatohet edhe në rastet e viktimave ndërkuftare (Neni 22, pika 5, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Rastet e Pa-pranueshme :

- Kompensimi nuk mund t'i jepet personit i cili është përgjegjës për vdekjen e viktimës (Neni 22, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Rastet ku shpenzimet e varrimit u mbuluan nga fondet publike (Neni 22, pika 4, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Shpenzimet e kompensueshme përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm në (Neni. 22, §3, UA (QRK) Nr 01/2017):

- shpenzimet e varrimit;
- pllakatë përkujtimore;
- kurora funeralesh;
- arkivoli;
- shpenzimet që lidhen me vendndodhjen e varrimit;
- shpenzimet për njoftimin e vdekjes së viktimës;
- shpenzimet e transportit;

Shuma maksimale:

- Tre mijë (3,000) Euro (Neni. 17, §2, Ligji Nr. 05/L-036)

(H) Shpenzimet procedurale për plotësimin e aplikacionit për kompensim

Rastet e Pranueshme :

- Komisioni mund të marrë në konsideratë mbulimin e shpenzimeve për lëshimin e dokumenteve, nëse Komisioni përcakton që dokumentet e tilla janë të rëndësishme për procesin e vlerësimit të nivelit dhe llojit të dëmit ose lëndimit të shkaktuar nga vepra penale (Neni 24, §1, UA QRK) Nr 01/2017).
- Në të gjitha rastet që Komision i kërkon dokumentacion shtesë nga aplikanti, shpenzimet për lëshimin e këtyre dokumenteve mbulohen nga Ministria e Drejtësisë (Neni 24, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Rastet e Pa-pranueshme :

- Pagesat e avokatit privat për asistencë në kompletimin dhe plotësimin e aplikacionit (Neni 29, pika 3, Ligji Nr. 05 / L-036, Neni 24, pika 4, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Shpenzimet e kompenzueshme:

- Shpenzimet për lëshimin e dokumenteve që konstatohet nga Komisioni si të rëndësishme për përcaktimin e llojit dhe shkallës së dëmeve (Neni 24, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Shpenzimet për lëshimin e dokumentacionit shtesë të kërkuar nga Komisioni (Neni 24, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Shuma maksimale:

- Nuk është specifikuar shuma maksimale nga Ligji.

(I) Transferi i kërkesës për kompenzim

Rastet e Pranueshme :

- Aplikuesi ka të drejtë të kërkojë transferimin e të drejtës së kompensimit në rastet kur viktimi vdes nga shkaqe që nuk kanë lidhje me krimin e kompensueshëm pas plotësimit të aplikacionit, dhe anëtarët e familjes kanë të drejtë kompensimi vetëm nëse kushtet e mëposhtme janë plotësuar kumulativisht Neni 22, pika 2, Ligji Nr. 05 / L-036)
- nëse para se të vdiste personi, Komisioni lëshoi një vendim për dhënien e kompensimit, por shpërblimi i kompensimit nuk u transferua ende në llogarinë e viktimave dhe;

- nëse anëtari i familjes ishte financiarisht i varur nga i vdekuri dhe nuk ka burime të tjera të mirëqenies.

Rastet e Pa-pranueshme :

- Në të gjitha rastet e tjera kur aplikanti vdes pas paraqitjes së kërkesës, e drejta për kompensim nuk është e transferueshme për asnjë varës (Neni 22, §1, ligji nr. 05 / L-036)

Hapi 7. Kalkulimi Final

Para marrjes së vendimit dhe llogaritjes përfundimtare të kompensimit (A) kompensimet potenciale nga burime të tjera dhe (B) rrethanat e tjera me ndikim do të merren në konsideratë.

(A) Kompensimi nga burimet e tjera

Gjatë procesit të vendosjes së kompensimit, merret parasysh çdo formë tjetër e kompensimit të marrë nga viktima. Më specifikisht:

- Shuma e kompensueshme për çdo lloj dëmtimi zvogëlohet në bazë të dëmeve të mbuluara për të njëjtin lloj dëmi nga burime të tjera (Neni 21, pika 1, ligji nr. 05 / L-036)
- Çdo rikthim i dhënë nga gjykata në çështjen penale për të cilën kërkohet kompensimi, përveç nëse nuk është paguar, merret në konsideratë edhe nga Komisioni i (Neni 21, pika 2, ligji nr. 05 / L-036).


(B) Rrethanat të cilat ndikojnë në kompensim

Një kërkesë për kompensim mund të refuzohet ose shuma e kompensueshme mund të zvogëlohet në bazë të mëposhtme (Neni 20, pika 1, ligji nr. 05 / L-036) (shih gjithashtu Nenin 2.1.6):

- "për shkak të kontributit të viktimës në shkaktimin e dëmit ose në përkeqësimin e dëmit të shkaktuar;
- për shkak të sjelljes së viktimës para, gjatë ose pas krimit;
- për shkak të përfshirjes së viktimës në krimin e organizuar ose anëtarësimin e tij në një organizatë që angazhohet në krimet e dhunës.
- nëse një shpërblim ose një shpërblim i plotë do të ishte në kundërshtim me ndjenjën e drejtësisë apo rendit publik".

E kaluara penale e një viktime të vdekur konsiderohet vetëm në rastet kur viktima ishte përfshirë në vepra të rënda penale, të cilat do ta bënin kompensimin një shkelje të ndjenjës së drejtësisë ose rendit publik, ose kompensimi do të përbënte një përdorim të padrejtë të fondeve publike (Neni 11, §3, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Ekuaioni 1: Formula finale e kalkulimit



Hapi 8. Vendimi

Komisioni vendos ose ta refuzojë kërkesën si të pabazuar ose ta pranojë tërësisht ose pjesërisht dhe të vendosë nivelin e kompensimit të dhënë (Neni 34 §2, Ligji Nr. 05 / L-036). Komisioni vendos llojin e shërbimeve që do të rimbursohen dhe në vendimin e saj përfundimtar përfshihet edhe shuma e shpenzimeve të kompensueshme (Neni 19, §2 & 3, Ligji Nr. 05 / L-036).

Procesi vendimmarrës:

- Kryesuesi i Komisionit thërret një mbledhje për vendosjen e një kërkesë (Neni 25, §1, Ligji Nr. 05 / L-036).
- Vendimet për aplikacionet për kompensim merren me shumicë votash (Neni 34, pika 1, ligji nr. 05 / L-036).
- Të paktën 2/3 e anëtarëve të Komisionit duhet të jenë të pranishëm gjatë çdo takimi (Neni 34, pika 3, Ligji Nr. 05 / L-036).
- Afati i fundit për marrjen e vendimit për një kërkesë është 90 ditë nga pranimi i aplikacionit të plotë (Neni 34, pika 4, Ligji Nr. 05 / L-036).

Hapi 9. Njoftimi mbi vendimin

Pas vendimit përfundimtar të Komisionit, një kopje e vendimit i jepet kërkuarit dhe gjykatës në detyrë (Neni 34, pika 5, ligji nr. 05 / L-036). Në rastet kur kërkuari është një individ që nuk ka aftësi për të vepruar ose një fëmijë, kopja e vendimit i sigurohet kujdestarit ligjor (Neni 34, pika 6, Ligji nr. 05 / L-036).

Me dhënien e vendimit përfundimtar në Gjykatën në detyrë, Komisioni gjithashtu do të njoftojë Gjykatën për detyrimin e tij për të transferuar në Buxhetin e Kosovës shumën e kompensimit ndaj viktimës, e cila i është dhënë viktimës nëpërmjet vendimit të saj (Neni. 18, § 5, UA (QRK) Nr 01/2017).


Me njoftimin e vendimit final të aplikuesit efekti do të jetë si në vijim:

- Klauzola për transferimin e padisë kundër kryerësit nga përfituesi në buxhetin e Republikës së Kosovës përfshihet në vendimin përfundimtar për dhënien e kompensimit (Neni 34, pika 8, ligji nr. 05 / L-036)
 - Në ditën e ekzekutimit të vendimit që njeh të drejtën e përfituesit për kompensim, kërkesa e përfituesit kundër kryerësit do t'i kalojë Qeverisë së Kosovës, deri në shumën e shpërblimit të dhënë (Neni 43, §1, ligji nr. 05 / L-036) dhe Qeveria e Kosovës tani vepron si përfituese kundër kryerësit të veprës (Neni 43, pika 2, ligji nr. 05 / L-036). Shuma e urdhëruar e kompensimit kundër të pandehurit, që i është dhënë viktimës nëpërmjet një vendimi të Komisionit, do t'i transferohet shtetit. Në raste të tilla, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për fillimin e të gjitha veprimeve zyrtare për të realizuar kthimin e shumës së dhënë me vendimin e Komisionit (Neni 43, pika 3, ligji nr. 05 / L-036). Bartja e kërkesës nuk përbën arsye për të hedhur poshtë një padi në pritje në gjykatat civile kundër kryerësit. Pasi që viktimë ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kompensim nga i pandehuri në një mosmarrëveshje civile në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe kompensimi i dhënë nga gjykata nuk konsiderohet si kompensim i dyfishtë për të njëjtën dëm (Neni 8, pika 4, & Neni 10, §3, UA (QRK) Nr. 01/2017).
 - Përfituesi ka detyrimin ta informojë Komisionin nëse kthimi është marrë nga burime të tjera, ose pas marrjes së kompensimit ose deri në ekzekutimin e vendimit të Komisionit (Neni 44, §2, Ligji Nr. 05 / L-036).
 - Aplikuesi ka të drejtë të fillojë proces administrativ kundër vendimit të Komisionit , në përputhje me legjislacionin në fuqi (Neni 34, §7, Ligji Nr. 05 / L-036).

Grafiku

Grafiku më poshtë (shih gjithashtu aneksin 1 të raportit aktual) përmbledh hapat proceduralë për vlerësimin e kërkesave për kompensim.

Figura 1: Grafiku për Vlerësimin e kërkesës



8. Fondet e fituara padrejtësisht

Komisioni dhe çdo palë tjetër e interesuar mund të informojë prokurorin e shtetit për rastet kur merret informacioni e cila tregon se kërkesa e përfituesit është shpërblyer në baza të datës së rreme ose të falsifikuar ose ndonjë mashtrimi tjetër (Neni 44, §1, ligji nr. 05 / L-036).

Përveç kësaj, në rastet kur kompensimi është marrë nga burime të tjera, ose pas marrjes së kompensimit ose deri në ekzekutimin e vendimit të Komisionit , përfituesi ka detyrimin ta informojë Komisionin (Neni 44, §2, Ligji Nr. 05 / L-036) .

9. Situatat ndërkufitare

Neni. 36, §1, of Ligji Nr. 05/L-036 dallimet në mes të dy llojeve të situatave ndër-kufitare:

- Një situatë ndërkufitare nacionale ndodh kur një krim është kryer në territorin e Republikës së Kosovës dhe viktima është shtetas i huaj. Në këtë rast, Komisioni është autoriteti vendimmarrës dhe kërkesa përcillet nga një autoritet ndihmës i vendit, shtetësinë e të cilit e ka viktima. Megjithatë, nëse viktima ka të drejtë të kërkojë qasje të menjëhershme në kompensim të viktimit (siç është paraparë në Nenin 9 të Ligjit nr. 05/L-036) dhe ende është në territorin e Republikës së Kosovës, viktima ka të drejtën e aplikimit direkt në Komision , si një viktimë e brendshme (Neni 9, pika 3, Ligji Nr. 05/L-036). Sidoqoftë, viktima ka të drejtën e qasjes në kompensim vetëm nëse Republika e Kosovës e merr përsipër këtë përgjegjësi nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare. Në rast se Republika e Kosovës i bashkohet BE-së, të njëjtat të drejta do të zbatohen automatikisht për qytetarët e shteteve të BE-së (Neni 45, Ligji Nr. 05 / L-036).
- Situata e huaj ndërkufitare ndodh kur krimi është kryer në tokë të huaj, megjithatë viktima që potencialisht ka të drejtën e kompensimit ka shtetësi të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, përshtatshmëria për kompensim vendoset nga autoriteti ekzistues i vendit ku ka ndodhur krimi dhe Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës vepron si një autoritet ndihmës, duke qenë përgjegjës për transmetimin e aplikacionit.

9.1 Situatat nacionale ndërkufitare (Neni 37, Ligji Nr. 05/L-036)

Pranimi i aplikacionit:

Pas marrjes së një kërkesë nga një autoritet i huaj asistues, Ministria e Drejtësisë brenda 30 ditëve do t'i sigurojë autoritetit kompetent të huaj informacionin e mëposhtëm:

- a. Një vërtetim pranimi
- b. Informata të personit përgjegjës ose departamentit përgjegjës
- c. Një tregues i kohës së përafërt me të cilën do të arrihet një vendim mbi aplikimin, nëse ky përafrim është i mundshëm.

Forma e aplikacionit dhe dokumentet përkrahëse:

- Autoriteti ndihmës është i detyruar të përdorë formularin standard të aplikimit nga Ministria e Drejtësisë, dhe aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën Shqipe, Serbe ose Angleze.
- Nëse aplikimi dhe/ose dokumentet shoqëruese dorëzohen në gjuhën angleze, nëse kërkohet, përkthimi në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës për anëtarët e Komisionit do të sigurohet në shpenzime të Ministrisë së Drejtësisë (Neni 26, § 6, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Nëse parakushtet e lartpërmendura nuk plotësohen ose aplikimi nuk është i plotë, Ministria e Drejtësisë do ta kthejë kërkesën tek autoriteti ndihmës (Neni 37, §2 & 3, ligji nr. 05 / L-036).

Vendimet e Komisionit:

Në përputhje me rrethanat, Ministria e Drejtësisë do të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues sa më shpejt që të jetë e mundur (Neni 37, pika 4, Ligji Nr. 05 / L-036). Neni 26, § 1 i UA (QRK) Nr. 01/2017 përcakton afatin kohor përkatës në 7 ditë. Komisioni më pas është i detyruar të bëjë një shqyrtim (Neni 26, §2 i UA (QRK) Nr. 01/2017), kryesisht për të vendosur nëse kushtet e Nenit 45 të Ligjit Nr. 05 / L-036, të cilat specifikojnë nëse Aplikanti ka të drejtë të kërkojë kompensim, janë plotësuar. Konkluzioni i rishikimit të Komisionit pastaj i përcillet Ministrisë së Drejtësisë, e cila në anën tjetër, brenda 60 ditëve, njofton viktimën nëpërmjet autoritetit të huaj ndihmës (Neni 26, §3, UA (QRK) Nr. 01/2017)

Procedurat e veçanta:

Në rastet kur procedurat e veçanta, si dëgjimi i një aplikanti, eksperti ose dëshmitari, konsiderohen të nevojshme, Komisioni mund t'i kërkojë autoritetit ndihmës të huaj që të kryejë procedurat përkatëse, të cilat mund të kryhen edhe përmes videokonferencës ose mjeteve të tjera të telekomunikacionit. Në të dy rastet procedimet do të kryhen vetëm nëse pajtohet personi që dëgjohet (Neni 37, §5 & 6, Ligji Nr. 05/L-036). Nëse duhet të bëhet dëgjimi përmes videokonferencës ose mjeteve të telekomunikimit, atëherë kjo kryhet nga Kryetari i Komisionit ose nga një anëtar i Komisionit i cili është i autorizuar nga Kryetari (Neni 37, 7, Ligji Nr. 05/L-036). Ministria e Drejtësisë do të lehtësojë dëgjimin duke koordinuar me autoritetin ndihmës të huaj për të siguruar që të ofrohet përkthimi për anëtarët e Komisionit, nëse është e nevojshme (Neni 26, §7, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Vendimi Final:

Kur Komisioni merr vendim, Ministria e Drejtësisë e dërgon vendimin tek autoriteti i huaj ndihmës brenda 60 ditëve nga lëshimi i tij. Nëse është e nevojshme, Ministria e Drejtësisë kujdeset që vendimi të përkthehet në gjuhën e pranueshme sipas ligjeve të vendit të huaj (Neni 26, 8 dhe 9, UA (QRK) Nr. 01/2017).

9.2 Situatat e huaja ndërkufitare (Neni 38, Ligji Nr. 05/L-036)

Në rastin e një shtate të huaj ndërkufitare Komisioni ka një përfshirje minimale aktive. Megjithatë, do të informohet vazhdimisht për çdo kërkesë dhe komunikim të mundshëm nga autoritetet e huaja (Neni 27, pika 7, UA (QRK) Nr. 01/2017).

Ministria e Drejtësisë është autoriteti publik përgjegjës për t'ju lehtësuar aplikantëve dhe për të komunikuar dhe ofruar ndihmë autoriteteve të huaja vendimmarrëse. Kontakti me autoritetet e huaja bëhet nëpërmjet zyrës për bashkëpunim juridik ndërkombëtar (Neni 27, pika 5, UA (QRK) Nr. 01/2017). Më specifikisht:

- Ministria e Drejtësisë lehtëson dëgjimet ose intervistat e aplikantëve, dëshmitarëve ose ekspertëve të kryer në Republikën e Kosovës nga Komisioni dhe dërgon një raport në bazë të këtyre procedurave tek autoritetet e huaja vendim-marrëse.
- Ndhmon në rast se procedimet e tilla kryhen nëpërmjet video-konferencës ose mjeteve të tjera të telekomunikacionit (Neni 38, §5 & 6, ligji nr. 05/L-036). Pëlqimi i personit për t'u dëgjuar, është, sipas situatave ndërkufitare kombëtare, një parakusht për fillimin e procedurave të tilla.

Megjithatë, Ministria e Drejtësisë nuk bën ndonjë vlerësim të aplikacionit (Neni 38, pika 7, ligji nr. 05/L-036). Veprimet e Ministrisë së Drejtësisë nuk mund të apelojnë ose të pranojnë kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve nga kërkuesi ose nga autoriteti i jashtëm vendimmarrës (Neni 38, pika 8, ligji nr. 05/L-036).

Procedurat e aplikimit:

- Aplikuesi mund të paraqesë kërkesën e tij/saj drejtpërdrejt në Ministrinë e Drejtësisë, duke përdorur formularin standard të aplikacionit të parashikuar (Neni 27, §1, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Ministria e Drejtësisë do të shqyrtojë kërkesën dhe brenda 60 ditëve do të informojë aplikuesin nëse ai është i mundshëm dhe i pranueshëm sipas ligjeve të shtetit ku është kryer vepra penale (Neni 27, §2, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Nëse kompensimi nuk është i mundur sipas ligjeve të shtetit në fjalë, aplikuesi duhet të informohet në përputhje me rrethanat brenda 30 ditëve nga marrja e këtyre informatave nga Ministria e Drejtësisë (Neni 27, §3, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Në të kundërtën, Ministria e Drejtësisë do të kontaktojë autoritetet e huaja në detyrë sa më parë që të jetë e mundur (Neni 27, pika 4, UA (QRK) Nr. 01/2017).
- Ministria e Drejtësisë do të përcjellë kërkesën dhe të gjitha dokumentet shoqëruese tek autoriteti vendimmarrës i huaj duke siguruar që:
 - Forma e saj i përmbahet asaj që kërkohet nga shteti në detyrë (Neni 27, § 6, UA (QRK) Nr. 01/2017).
 - Është dërguar në një nga gjuhët zyrtare të shtetit në fjalë ose në një gjuhë tjetër zyrtare të BE-së, që shteti pritës ka treguar se do ta pranojë (Neni 27, § 6, UA (QRK) Nr. 01/2017). Ministria e Drejtësisë mbulon shpenzimet e nevojshme të përkthimit (Neni 27, 8, UA (QRK) Nr. 01/2017)

Në rast se aplikacionet konsiderohen të papranueshme ose kërkohen informata shtesë nga autoritetet vendimmarrëse të huaja, Ministria e Drejtësisë njofton menjëherë aplikuesin. (Neni 38, §2, Ligji Nr. 05 / L-036).

Sapo të arrihet një vendim i autoritetit vendimmarrës dhe t'i komunikohen Ministrisë së Drejtësisë, Ministria duhet ta njoftojë sa më shpejt aplikuesin (Neni 27, pika 10, UA (QRK) Nr. 01/2017). Ndërkohë, dhe në periudha kohore ajo do të kontaktojë autoritetet ekzistuese duke bërë kërkime për statusin e aplikacioneve të cilat janë në pritje (Neni 27, § 11, UA (QRK) Nr. 01/2017).

10. Të dhënat personale – Mbrojtja e të dhënave

10.1 Kërkesa për të dhëna

Komisioni ka të drejtë të kërkojë informata që mund të konsiderohen si të dhëna personale nga autoritetet publike/shtetërore/vetëqeverisëse dhe organet që ushtrojnë kompetenca publike, si dhe nga individë (Neni 35, Ligji Nr. 05/L-036) (Shih gjithashtu pjesën 1.5). Mund të supozohet se edhe personat juridikë mund të përfshihen nën termin "individë", megjithatë një interpretim i tillë nuk duhet të konsiderohet i vetëkuptueshëm.

Të dhënat e kërkuara duhet të jenë të rëndësishme për qëllimet e vendimmarrjes (një term tepër i paqartë) dhe kërkesa për paraqitjen e tyre duhet të jetë në formë të shkruar. Pas marrjes së një kërkesë të tillë transferimi i të dhënave të përmendura është i detyrueshëm për organet publike dhe vullnetare për individët (Neni 35, pika 2, ligji nr. 05 / L-036).

10.2 Qasja në të dhëna

Qasja në përmbajtjen e një kallëzimi penal, lidhjet e tyre, raportet pranë Prokurorisë së Shtetit, paditë penale dhe vendimet gjyqësore që janë në posedim të Komisionit mund të vihen në dispozicion vetëm për anëtarët e Komisionit, viktimën ose përfaqësuesin e tij ligjor, përfaqësuesit i autorizuar dhe autoritetet kompetente shtetërore (Neni 35, pika 3, ligji nr. 05 / L-036). Prandaj, sapo Komisioni të jetë në posedim të dokumenteve të tilla, ajo nuk duhet të zbulojë përmbajtjen e saj palëve të treta, përveç atyre që ligji parashikon.

Palët dhe pjesëmarrësit në procedurën e kompensimit do të kenë qasje në dëshmi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për qasje në dokumente publike dhe duke marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (Neni 7, UA (QRK) Nr. 02/2017).

Të gjitha të dhënat e përfshira në aplikacion do të përdoren vetëm me qëllim të ushtrimit të së drejtës së viktimës për kompensim financiar dhe jo për qëllime të tjera (Neni 9, §3, UA (QRK) Nr. 01/2017).

11. Mbajtja e shënimeve (dokumenteve)

Mbajtja e shënimeve mbahet në bazë të rasteve individuale dhe secili rast i atribuohet një numri me paraqitjen e një kërkesë. Forma dhe përmbajtja e regjistrimeve dhe mënyra e tyre e mbajtjes rregullohen me Udhëzimin Administrativ (QRK) NR. 02/2017 "Për regjistrat për aplikantët dhe vendimet e lëshuara për kompensim" siç parashikohet direkt nga Neni 41. Aspektet kyçe të mbajtjes së evidencës të parashikuar janë: Përshkruar më poshtë.

11.1 Regjistri

Të gjitha aplikacionet dhe dokumentet përkatëse mbahen në një regjistër në kopje të shkruar (Neni 2, UA(QRK) Nr 02/2017), në rend kronologjik (Neni 3, §3, UA (QRK) Nr 02/2017), duke përmbajtur informata për secilin rast dhe aplikacion (Neni 3, §1, UA (QRK) Nr. 02/2017):

1. emri dhe mbiemri (i aplikuesit);
2. emri dhe mbiemri i një prindi;
3. data e lindjes;
4. vendi i lindjes, komunës dhe shtetit;
5. adresa e tanishme;
6. varësi;
7. vendimi i Komisionit;
8. kërkesa për kompensim;
9. llojet e kompensimit;
10. numrin personal të dokumentit valid të identifikimit;
11. gjinia;
12. statusi civil
13. etnia

Në rastet kur disa aplikues iniciojnë një procedurë të përbashkët, krijohet një regjistër i vetëm dhe të dhënat e të gjithë aplikuesve mbahen së bashku (Neni 3, pika 4, UA (QRK) Nr. 02/2017).

Regjistri mbyllet çdo vit, pasi është nënshkruar nga Komisioni (Neni 4, UA (QRK) Nr 02/2017).

11.2 Dokumenti i Komisionit

Dokumenti i Komisionit përbëhet nga akte të nxjerra nga Komisioni, kopje të dokumenteve relevante, parashtresave, autorizimeve, gjetjeve dhe parashtresave të tjera. Sipas kësaj skeme të mbajtjes së regjistrave, krijohet një dosje për secilin rast, duke renditur dhe bashkangjitur të gjitha dokumentet e rregullta (Neni 5, UA (QRK) Nr. 02/2017).

Pas përfundimit të të gjitha veprimeve përkatëse të Komisionit dhe pasi Komisioni i konfirmon që çështja nuk është më në pritje, Dokumentet arkivohen (Neni 6, UA (QRK) Nr. 02/2017).

11.3 Ri-lëshimi i dokumenteve

Në rast se ndonjë prej Dokumenteve është humbur, dëmtuar ose shkatërruar, ajo do të ribotohet me koston e Ministrisë së Drejtësisë. Për rilëshimin e dokumenteve të një procedure të vazhdueshme, presupozohet një vendim i Komisionit (Neni 6, §4, 5, dhe 6AI (QRK) NR 02/2017).

11.4 Qasja në regjistra

Qasja në regjistrat jepet sipas Neni 7 të UA (QRK) Nr. 02/2017): "*Komisioni është i detyruar që, në përputhje me legjislacionin në fuqi për qasje në dokumente publike, të sigurojë qasje në dëshmi për palët dhe pjesëmarrësit në Procedurën për kompensim, duke marrë parasysh legjislacionin e aplikueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale*".

11.5 Kohëzgjatja e rruajtjes (magazinimit)

Neni 41, pika 1 e Ligjit Nr. 05/L-036 nënkupton që të gjitha dosjet e mësipërme nuk mund të mbahen për një periudhë të pacaktuar. Kjo është vetëm e arsyeshme duke marrë parasysh konsideratat dhe detajet praktike të zbatueshme të Ligjit për Privatësi (kapaciteti i magazinimit). Megjithatë, UA (QRK) Nr. 02/2017 nuk bën asnjë vërejtje për kohëzgjatjen minimale ose maksimale të ruajtjes së secilës dosje dhe/ose kategorinë e të dhënave dhe kështu autoritetet do të përfitonin nga udhëzimet e Agjencisë Nationale për Mbrojtjen e të dhënave personale për këtë çështje.

12. Aspektet Financiare

Programi i Kompensimit të Viktimave të Krimit financohet përmes fondeve publike që përbëjnë një pjesë të buxhetit vjetor të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës dhe gjithashtu mund të financohen përmes kontributeve vullnetare dhe donacioneve private, në përputhje me Rregullat e Kontrollit Financiar dhe Menaxhimit (Neni 39 , §1 & 2, Ligji Nr. 05 / L-036). Një pjesë e të ardhurave mund të vijnë nga sanksionet penale të caktuara në mënyrë specifike nga gjykatat në rastet e trafikimit si më poshtë (Neni 39, pika 3, ligji nr. 05 / L-036):

- a. Për veprat penale të gjykuara nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatave Themelore shuma prej tridhjetë (30) Euro;
- b. Për veprat penale të gjykuara nga Departamenti i Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore shuma prej pesëdhjetë (50) Euro.

Të hyrat e planifikuara nga ky burim merren parasysh përpara se të finalizohet kërkesa për buxhetin e Programit të Kompensimit të Viktimave të Krimit. Para se të finalizohet alokimi i buxhetit, të merren parasysh burimet e tjera të mundshme të të ardhurave siç janë asgjësimi i aseteve të konfiskuara, të ardhurat nga "dorëzania" e konfiskuar etj. (Neni 39, §4 & 5, Ligji Nr. 05 / L-036.)

Sipas informacionit të dhënë nga Ministria e Drejtësisë, për vitin 2017, një fond prej 100,000 Eurosh i është ndarë Programit të Kompensimit të Viktimave. Fondi do të përdoret për kompensimin e viktimave dhe përfituesve si dhe kompensimin e anëtarëve të Komisionit . Në pajtim me Neni 25, pika 3, e cila parasheh kompensimin e anëtarëve të Komisionit për punën e tyre, vendimi përkatës i Qeverisë Nr. 05/145 ka vendosur kompensimin e Kryetarit dhe të Anëtarëve nga treqind (300) dhe dyqind e pesëdhjetë (250) Euro në muaj respektivisht, duke filluar nga janari 2017.

Ministria e Drejtësisë gjithashtu do të dorëzojë një raport vjetor në Ministrinë e Financave duke përfshirë (Neni 40, Ligji Nr. 05 / L-036):

1. numri i përgjithshëm i aplikantëve;
2. numri i mohuar i aplikantëve për kompensimin;
3. numri i dhënë i kompensimeve për aplikantë;
4. shuma e kompensimit që u jepet aplikuesve dhe
5. shpenzimet e Komisionit.